



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më
 12.7.2012, e cila filloi në orën 11:00.**

Në mbledhje morën pjesë: prof. dr. Isa Mustafa, kryetar i Komunës, Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit të Komunës, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Hetem Kupina, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Avdush Dobratiqi, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Shefki Uka, Musli Mehaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Klllokoqi, Shemsi Veseli, Skënder Reçica, Liridon Restelica, Afërdita Veliu, Besa Halimi – Zagragja, Lumnie Rama, Shefqet Sylejmani, Astrit Hasani, Meliza Haradinaj, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Feti Mejdiu, Kimet Zeqa dhe Sadri Ramabaja.

Munguan: Engin Beyoglu, Valon Hiseni dhe Fetah Salihu.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE – së, të shoqërisë civile dhe të mjeteve të informimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit.

U konstatua se njëzëri u miratua ky

R E N D D I T E:

1. **Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit;**
2. **Raporti i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko - financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese për periudhën janar - qershor 2012;**
3. **Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues urban të lagjes “Mati 2”;**
4. **Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues urban të lagjes “Lakërishta”;**

5. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues urban të lagjes "Sofalia";
6. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues urban të lagjes "Arbëria 3";
7. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Sallës univerzale kulturore në Prishtinë;
8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të banimit për rastet me përkujdesje sociale dhe të objektit të banimit për familjet e dëshmorëve, invalidët, veteranët e luftës dhe nevojat e shpronësimeve;
9. Pyetje dhe përgjigje;
10. Të ndryshme.

Pika e parë

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit.

Pika e dytë

Lidhur me Raportin e Kryetarit të Komunës për situatën ekonomike-financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese për periudhën janar - qershor 2012, kryesuesi tha se në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, është obligim që Kryetari i Komunës në periudhën gjashtëmujore dhe njëvjeçare, të raportojë rreth situatës ekonomike - financiare.

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me këtë pikë.

Tefik Mehmeti, në emër të GP të LDK-së, tha se ky raport paraqet të arriturat e përgjithshme, si ato buxhetore, ashtu edhe gjendjen ekonomike dhe sociale në komunë, si dhe planifikimet dhe realizimet e punëve dhe furnizimeve për periudhën në vazhdim.

Përmbledhja kryesore është filluar nga buxheti dhe të hyrat vetanake, ku shihet një lëvizje pozitive drejt ngritjes së të hyrave vetanake. Në bazë të shifrave dhe tabelave, jepet një pasqyrë e qartë mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për këtë gjashtëmujor, duke e krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sa i përket realizimit të të hyrave vetanake, shihet se është diku te kuota e planifikimeve.

Te mirëqenia sociale është shqetësuese rritja e numrit të familjeve që janë shfrytëzuese të asistencës sociale. Mendojmë se Komuna në këtë aspekt ka bërë aq sa ka pasur kompetenca, por ndërtimi dhe ndarja e banesave për rastet e tilla, duhet të vazhdojë dhe me prioritet.

Te investimet kapitale, mendojmë se është një listë mjaft e gjerë e projekteve në realizim e sipër, si dhe e atyre që pritet të realizohen si në infrastrukturën rrugore, ashtu edhe në objektet arsimore, kulturore dhe sportive.

Edhe projektet në fushën e urbanizmit dhe planifikimit janë në rrugë të mbarë, vetëm se këtu ndoshta kërkohet pak më shumë azhuritet.

Në fushën e ekonomisë dhe zhvillimit rural, gjithashtu janë projektet me një shtrirje të llojllojshme në bazë të mundësive buxhetore, për subvencionime në këtë fushë.

Në fushën e shërbimeve publike gjithashtu është një listë mjaft e gjerë e projekteve në realizim apo të realizuara.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se këtë raport e kemi analizuar, me përjashtim të disa vërejtjeve rreth ndërmarrjeve publike, të gjitha të tjerat janë të pranueshme. Është e rrugës që ndërmarrjet publike një herë e përgjithmonë të shkruajnë dhe të tregojnë realitetin e gjendjes së tyre që e kanë. Nuk është saktësisht ashtu si shkruhet dhe thuhet në këtë raport, d.m.th. raporti ka ardhur nga ana e tyre, por megjithatë kemi vërejtje se mendojmë që në ndërmarrjet publike të gjitha punët nuk janë dhe aq në rregull, pra nuk janë ashtu siç është shkruar.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe ne e kemi analizuar në mënyrë profesionale raportin e gjashtëmujorit.

Fillimisht dua ta përshëndes punën dhe angazhimin që ka bërë kryetari me ekipin e vet rreth dorëzimit të këtij raporti.

Unë jam i vetëdijshëm që nganjëherë ka disa mosharmonizime në mes të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe Ligjit për menaxhimin e financave publike, gjersa aty në mënyrë taksative shkruan se kryetari është i obliguar në tremujor, në Ligjin për vetëqeverisje lokale, së paku një herë në gjashtëmujor, Kuvendit duhet t'ia dorëzojë një raport. Andaj, konsideroj se duke dhënë sugjerimet dhe rekomandimet të gjitha grupet parlamentare, atëherë edhe do të pasurohet raporti.

Këtij raporti ndoshta është dashur t'i paraprijë një analizë më e thellë. Ky raport do të ishte begatuar shumë sikur të paraqiteshin edhe sfidat afatshkurtra, afatmesme, afatgjate, objektivat, alternativat e mundshme, pengesat që janë bërë, cilat janë mundësitë për rrugëdalje dhe cilat janë kërkesat që kishin për t'u bërë në raport me Kuvendin, që Kuvendi të merr një vendim dhe t'ia mundësojë dhe lehtësojë menaxhimin e buxhetit sa më mirë.

Nga tabela e të hyrave vetanake, në disa drejtori shihet se ka avancime, ndërsa në disa të tjera ka ngecje. Këtu është çështja ose pse s'është bërë identifikimi dhe planifikimi i mirë, ose kemi të bëjmë me problemin tash që është, ajo shumë që është planifikuar është shumë e madhe, apo është problemi se nuk e kanë gjetur formën për ta bërë arkëtimin e asaj.

Kemi rënie në arkëtimin nga licencat për biznese, edhe këtu është dashur të kemi një dinamikë më të theksuar.

Sa i përket lejeve të nderimit, kërkoj që planifikimi të jetë sa më real dhe të kemi

mundësi që në këtë aspekt Komuna e Prishtinës të vjelë mjete dhe në këtë mënyrë buxheti i Komunës së Prishtinës të rritet dhe të shkojë në dobi të qytetarëve të saj.

Është për t'u përshëndetur lëvizja e drejtorit të ri, konkretisht rreth lejeve të ndërtimit, sidomos kur e kemi parasysh edhe procesin për legalizimin.

Investimet kapitale janë pak shqetësuese dhe se në këtë gjashtëmujor të parë kemi një ritëm tejet të ngadaltë të projekteve.

Auditimi i jashtëm gjithmonë po konstaton se nuk po bëhet planifikim i mirëfilltë. Mundësitë që paratë e planifikuara për kategoritë mos të shkojnë në suficit, nuk shpenzohen. Edhe një herë po e theksoj, është një bazë e planifikimit që duhet të jetë më i qëndrueshëm dhe më real e më profesional.

Sa i përket shpenzimeve totale të buxhetit, vlera prej 22.65%, po ashtu kjo tregon se edhe përkundër faktit se ka mjete buxhetore, nuk janë shpenzuar as minimumi sa i përket prej 45 % të buxhetit, ku dihet se Komuna e Prishtinës ka nevojë për shumë mjete tjera dhe mosshpenzimi konform Ligjit të buxhetit për menaxhimin e financave publike, vijnë deri te situata ku ato mund të merren edhe nga Ministria e Financave, siç e dimë. Menaxhimi i parasë publike nënkupton edhe dhënien e llogarisë dhe të mjeteve nëse nuk shpenzohen me kohë dhe si duhet.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, tha se e kemi shqyrtuar këtë raport në mënyrë shumë analitike dhe studiuese, i kemi hy shqyrtimit të këtij raporti, dhe për të mos u përsëritur disa nga vlerësimet e parafolësve, atëherë ne do t'i shtrojmë disa çështje, të cilat i konsiderojmë të nevojshme, që do të ishin pjesë e konstatimit, gjegjësisht vlerësimin të këtij raporti gjashtëmujor.

Ne si GP asnjëherë nuk i kemi konsideruar si mjete të tepruara mjetet që barten nga viti në vit, duke e ditur fare mirë ecurinë financiare, por edhe obligimet ligjore që i kemi, prandaj mjetet që barten nga viti në vit, ato nuk janë teprica, dhe ne si GP ato i arsyetojmë plotësisht.

GP i AAK-së në segmentin e realizimit të të hyrave vetanake, në veçanti nga tatimi në pronë, e konsideron të nevojshme ta thotë një vlerësim se, me gjithë intencat e shoqërisë sonë kosovare për zhvillim ekonomik etj., po ballafaqohemi megjithatë me një rënie të fuqisë financiare të qytetarëve, dhe në këtë segment edhe të qytetarëve të komunës së Prishtinës, dhe në një mënyrë e kemi arsyen pse ndoshta në këtë aspekt po ngecet edhe në Komunën e Prishtinës, sidomos në arkëtimin e mjeteve nga tatimi në pronë, dhe në tatimet tjera. Ndoshta për këtë çështje duhet të mendohet. Ne si GP do të mendojmë se ndoshta në të ardhmen do të bëhet një zbritje edhe më e madhe e shkallës së tatimit.

E përkrahim këtë raport plotësisht, si shumë objektiv, real, të drejtë dhe një punë të suksesshme. Urojmë që në të ardhmen ekzekutivi, por edhe Kuvendi i Komunës, të veprojnë në frymën e kësaj dhe këtyre konstatimeve dhe vlerësimeve që i kemi, sepse kështu mendoj që e ndajmë suksesin e përbashkët edhe ne si GP veç e veç, që jemi pjesë përbërëse e këtij Kuvendi, dhe krejt këto në raport me përgjegjësitë që i kemi para qytetarëve të cilët na kanë zgjedhur.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, tha se, me që jemi përcjellës të punëve dhe zhvillimit në qytetin e Prishtinës me rrethinë, mund të konstatojmë se raporti është real, edhe pse nuk i kënaqë në nivel të lartë nevojat e qytetarëve të Komunës së Prishtinës. Është pak shqetësues fakti se në raport, te shpenzimet kapitale, përgjegjësia është natyrisht e ekzekutivit, por edhe ligji i cili e përcakton dhënien e kryerjes së punimeve përmes Zyrës së prokurimit kompanive më të lira, edhe ajo është, sipas mendimit tim, një pengesë jashtëzakonisht e madhe, dhe që shpeshherë po ndodhë që ato punë po zvarriten jo një vit, por me vite të tëra, derisa po përfundojnë. Kisha kërkuar, si anëtarë i Asamblesë komunale, që nëse një kompani disa herë dështon në kryerjen e punimeve, t'i jepen referenca negative dhe ajo kompani mos ta pengojë procesin e prokurimit në të ardhmen. Me sa duket në praktikë janë nja 4 - 5 kompani, të cilat e marrin një punë, qoftë e vogël apo e madhe, dhe e zvarrisin me vite atë punë dhe nuk bëjnë asgjë.

Te legalizimet, mendoj se këtij procesi duhet t'i jepet një rëndësi shumë më e madhe, sepse po e dini që edhe zhvillimi ekonomik, dhe gati edhe mbijetesa ka ardhur prej një çështjeje të hipotekës së pronës që e posedojnë qytetarët, kështu që ajo pronë e cila nuk është e legalizuar, ajo nuk mund të hipotekohet, dhe qytetarët kanë probleme rreth kësaj. Më parë kam propozuar që të jetë një sektor i veçantë, ndoshta edhe një staf i veçantë për legalizimin e atyre objekteve. Gjithashtu në këtë raport është dashur që të parashihen, të ndahen mjete edhe për disa komisione të cilat po angazhohen, si për emërtimin e rrugëve, ndarjen e banesave dhe disa punë të tjera, punë të cilat po shkojnë së koti.

Feti Mehdiu, në emër të Partisë së Drejtësisë, tha se raporti në përgjithësi është i kompletuar, me ndonjë të metë të vogël, që sigurisht përgjegjësit do t'i kenë parasysh vërejtjet që u dhanë. Një gjë që mendoj se duhet të theksohet, ne e kemi vënë theksin te Trafiku Urban, kam një pyetje dhe eventualisht një sugjerim, në qoftë se nuk është e paraparë si duhet atje. Aty është e paraparë që do të bisedohet edhe për partneritetin publiko - privat për Trafikun Urban. Unë do t'ju kujtoj se njëherë këtu është biseduar për çështjen e transportit të pensionistëve dhe të studentëve. Na intereson këtu, kur e keni bërë këtë, a keni paraparë dhe çfarë propozimesh keni për ta realizuar qëllimin, transportin e pensionistëve dhe të studentëve, me këtë ndërmarrje publiko - private? Në qoftë se nuk e keni, nuk keni bërë diçka konkret, si do ta realizoni, sepse atëherë u shprehen disa skepticizma që mund të ketë probleme për shkak të atyre gjysmë të regjistruara, nuk i kanë afatet si duhet etj., atëherë duhet ta keni parasysh që kjo çështje duhet të zgjidhet. Çështja e udhëtimit të pensionistëve dhe studentëve duhet të zgjidhet.

Ka vende të ndryshme në Evropë që i kanë të dy sektorët dhe funksionojnë si duhet, andaj për këtë duhet bërë një analizë, pasi që ka vend që këta dy sektorë të trafikut të funksionojnë.

Sadri Ramabaja, Lëvizja Vetëvendosje, tha se ky raport, me një shikim shumë sipërfaqësor, na shpërfaq gjendjen ekonomike të mjerë dhe gjendjen sociale gjithnjë edhe më të mjerë të qytetarëve të Kosovës.

Nëse kryetari dhe të gjithë bashkëpunëtorët e tij, por edhe ne këtu, jemi për të forcuar këtë mirëqenie, ky raport nuk dëshmon se punët po na ecin mirë. Madje, pavarësisht faktit se është bërë përpjekje që të prezantohet çdo gjë e mirë e mundshme, madje të prezantohen edhe objektet që financohen prej donatorëve të mundshëm, prej ministrive etj., kapaciteti i zhvillimit ekonomik të kryeqendrës sonë len jashtëzakonisht shumë për të dëshiruar! Kjo ndodh për shkak se edhe menaxhimi i atyre resurseve ekzistuese të Komunës, është sikur të ishte mall i huaj.

Sa i përket partneriteti publiko - privat, është një fushë ku mund të kemi përfitime të kënaqshme, çka shihet edhe nga këto projekte, por këtu mund të përfitojmë më shumë dhe të orientohemi në këtë drejtim.

Më shqetëson fakti se nga buxheti për këtë vit, se edhe këtë kapital që e kemi nuk e menaxhojmë si duhet, megjithatë pasqyra tregon qartë se në çfarë gjendje ekonomike është qyteti, ku bazohet në të hyrat e saj etj., madje sidomos te planifikimi dhe realizimi i tij.

Mua më shqetëson edhe një fakt tjetër. Nga auditori, vetëm dy ditë më herët, para se të bëhet ky raport, ka ardhur përgjigjja, nuk e di sa është trajtuar si duhet për dy ditë. Do të kisha pasur dëshirë që të kemi shpjegime pak më të veçanta te pika 5, rreth mirëqenies sociale. Natyrisht, këto të dhëna që janë këtu, janë të dhëna si të thuash të domosdoshme që të prezantohen, sepse qytetarët po vijnë për çdo ditë në derë të Komunës dhe po paraqiten si raste sociale, kjo shifër është jashtëzakonisht e zbutur, e vogël, 21 familje janë më shumë raste sociale se në vitin e kaluar.

Në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, është prezantuar këtu një pasqyrë e 11 veprave, ku po insistohet të investohet etj, ne jemi kryeqyteti ku investohet më së paku në kulturë, dhe do të ishte shumë dëm nëse nuk korrigjohet së paku në gjashtëmujorin e ardhshëm.

Në fushën e ekonomisë dhe zhvillimit rural, çështjet do të duhej trajtuar ndryshe. Në fakt, në këtë raport nuk është thënë pothuajse asgjë për ndërmarrjet publike, kur e dimë se në çfarë gjendje janë ato, siç janë NPK-të: "Pastrimi" ," Trafiku Urban" "Termokos" etj. këto po menaxhohen tamam si feude të huaja.

Astrit Hasani tha se e përshëndes ndërtimin e 5 fushave sportive në Velani, Kodrën e Diellit dhe Kodrën e Trimave. Po ashtu e përshëndes edhe iniciativën për ndërtimin e objektit të sallës universale kulturore në Prishtinë, e cila është shumë e nevojshme për rininë e Prishtinës. Unë po e shoh që është në proces të tenderimit edhe hartimi i zgjidhjes ideore për pishinë, dhe amfiteatrin në pishinën e Gërmisë. Një gjë që e kisha kërkuar nga Drejtoria e Sportit, është që të jetë shumë vigjilente në këtë projekt, dhe të sigurohet që kjo të jetë një pishinë me standarde olimpike, e cila është shumë e nevojshme për rininë e kryeqytetit tonë.

Skënder Reçica tha se në bazë të këtij raporti Komuna e Prishtinës konstaton se në periudhën janar - qershor 2012, nga të hyrat vetanake, nga shuma e tërësishme e planifikuar, ka realizuar 47.68%. Në tabelën numër 1 të këtij raporti janë paraqitur të gjitha burimet e të hyrave dhe janë bërë krahasime me vitin

paraprak, janë dhënë edhe disa informacioneve pse në disa sektorë është më i lartë niveli i realizimit e pse në disa më i vogël. Janë dy çështje që unë dëshiroj t'i potencoj para jush, sa i përket të hyrave vetanake, që kanë të bëjnë me atë që auditori i përgjithshëm i ka paraqitur në raportin e auditivit, te pasqyra vjetore financiare e Komunës së Prishtinës për vitin 2011, ku është konstatuar:

- te borxhet e papaguara te taksat për lejet e ndërtimit, është identifikuar se Komuna nuk i kishte ekzekutuar garancitë e siguruara, që obliguesit i kishin bërë për borxhet që i kishin ndaj Komunës,

- të hyrat nga dhënia me qira të tokës për nevojat e ndërmarrjes "Tregu", bëhet fjalë për marrëveshjen për nën qiradhënie në mes të Komunës së Prishtinës dhe ndërmarrjes "Tregu", nuk janë gjetur dëshmi se pagesat mujore janë bërë nga ndërmarrja "Tregu".

Është mirë që menaxhmenti i Komunës të na njoftojë neve nëse këto gjetje janë adresuar. Ne shpresojmë se janë nxjerr mësim nga këto lloje të veprimtarive, dhe për hir të taksapaguesve të njëjtat nuk janë përsëritur në pjesën e parë të këtij viti.

Te shpenzimet buxhetore për periudhën raportuese, Komuna e Prishtinës, nga mjetet e planifikuara për tu shpenzuar për këtë vit dhe mjetet e bartura nga viti paraprak, ka shpenzuar 22.65%, si zakonisht ngecjet e shpenzimit të buxhetit janë në investimet kapitale 9.38% nga totali i përgjithshëm, që krahasuar me vitin e kaluar nuk është ndonjë ngritje e kënaqshme e shpenzimit të buxhetit sipas dinamikës së paraparë.

Rreth shpenzimeve për mallra dhe shërbime, sipas tabelës 53.62% janë shpenzimet për mallra dhe shërbime në pjesën e parë të këtij viti. Kërkoj nga menaxhmenti që të na ofrojë neve dhe qytetarëve të Prishtinës më shumë të dhëna për atë se në çka dhe si janë shpenzuar këto mjete.

Shqetësimi ynë ka të bëjë edhe me gjetjen e auditorit të përgjithshëm në testimin e shpenzimeve të derivateve për ngrohjen e shkollave.

Dëshiroj të theksoj se në përgjithësi raporti i Kryetarit të Komunës për periudhën janar - qershor 2012, edhe pse është një raport mbi situatën ekonomike - financiare, karakterizohet me një përshkrim sipërfaqësor, pa hyrë në analiza të punës dhe aktiviteteve, pa u prekur fare disa sektorë, të cilët kanë të bëjnë me fushën e gjendjes ekonomike. Në këtë raport vërehet mungesa e vlerësimit të nivelit të përmbushjes së planit të punës, apo mos përmbushjes së tij.

Kimet Zeqa theksoi se dezinfektimi qe 10 -12 vjet nuk është bërë më i mirë se këtë herë dhe jam e kënaqur shumë në këtë drejtim. Janë të arriturat të mjaftueshme, por nga Komiteti për shëndetësi kurrfarë informata nuk ka qe një vit se çka po ndodhë në shëndetësi, për këtë është i informuar Kryetari, kryesuesi dhe të gjithë të tjerët.

Më intereson edhe ndërtimi i QMF-së, projekti është duke u realizuar, por unë sa e di, kur është vënë gurthemeli është paraparë për 100 ditë, nuk e di deri ku ka mbërri, sepse nuk kemi informata. Unë që punoj në shëndetësi, i shoh pacientët duke bredhur poshtë - lart, e pyesin kur do të fillojë, e për atë nëse nuk është bërë

për 100 ditë, me siguri kanë kaluar 100 ditë, kush përgjigjet për këtë, çfarë përgjegjësie ka kompania?

E dyta, edhe furnizimi, pra vendosja e pajisja mjekësore, klimave, është më se e domosdoshme që të krijohen kushte më të volitshme për punë dhe për pacientë. Lus që, në qoftë se ka mundësi, në këtë drejtim të punohet, bile ku është më se e nevojshme të vendosen klimat për punëtorët dhe për pacientët.

Prof.dr. Isa Mustafa fillimisht i përshëndeti të pranishmit, duke i falënderua për vlerësimet e dhëna lidhur me raportin dhe sugjerimet e dhëna.

Lidhur me shpenzimet e buxhetit, tha se kemi pasur një takim të veçantë me drejtorët e drejtorive, kanë qenë edhe një pjesë e anëtarëve të KPF-së, kemi punuar paralelisht në kornizat e buxhetit për vitin 2013, dhe e kemi bërë dhe analizën e ekzekutimit të buxhetit të vitit 2012, me disa sugjerime, të cilat më vonë do t'i bartim edhe në Kuvend, në mënyrë që të realizohet buxheti.

Kemi vlerësuar që ekzekutimi i buxhetit, në pikëpamje të shpenzimeve, nuk është në nivelin e duhur, dhe kemi marrë masa që të ekzekutohet në këtë vit, në nivel shumë më të lartë sesa që është ekzekutuar në vitin e kaluar.

Në fushën e arsimit kemi pasur disa ngecje, që kanë qenë të lidhura më tepër me hapësirat për ndërtimin e shkollave. Jemi duke shikuar mundësinë për ndërtimin e një pishine në Gërmi me standarde evropiane, gjithashtu është një propozim për ndarje të lokacionit për ndërtimin e një qendre, të cilën ne do ta kemi si qendër kulturore, që do të shfrytëzohet në Prishtinë, dhe jo vetëm nga Prishtina, por edhe nga komunat tjera.

Për dy projekte me bashkëfinancim me donatorët e jashtëm, që njëra është për Ujësjellësin dhe tjetra për Termokosin, pritet që këto të përfundojnë dhe të jenë në shërbim të qytetarëve.

Janë edhe shumë projekte të tjera, si në infrastrukturë, në shëndetësi etj. që priten të realizohen.

U konstatua se u përkrah Raporti i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko - financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese për periudhën janar - qershor 2012

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimi për fillimin e hartimit të planit rregullues urban të lagjes "Mati 2", informoi Behxhet Musliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, duke shtuar se në bazë të detyrave programore të drejtorisë dhe prioriteteve të Komunës në realizimin e projekteve kapitale për këtë vit, është paraparë, përveç tjerash, edhe hartimi i planit rregullues për hapësirën e emërtuar si "Mati 2".

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se ne e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë propozimvendim. Ne si grup do të përkrahim dhe do të votojmë për miratim.

Aziz Pacolli në emër të GP të AKR-së, tha se edhe ne jemi për miratimin e këtij propozimvendimi, me një kërkesë, siç kërkoi edhe z. Gashi, që firmat të cilat marrin si projektimet, si ndërtimet, të jenë firma profesionale, në mënyrë që të mos kemi më problem me punën e tyre si në hartimin dhe në ekzekutimin e planeve të tilla.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe grupi jonë parlamentarë e përkrah sa i përket vendimit, sepse është edhe obligim ligjor, sepse Komuna e Prishtinës duhet t'i ketë planet rregulluese. E përshëndesim fillimin e hartimit të këtij plani dhe njëherësh urojmë që kompanitë që do t'i hartojnë planet tjera rregulluese, të jenë më të përgjegjshme, për arsye se, jemi dëshmitarë të kohës, kur po ka plane, të cilat quhen plane rregulluese, por nuk i kanë elementet e mirëfillta të planeve rregulluese.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, tha se e kemi një sugjerim që, lidhur me këtë plan, njerëzit në Drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, të jenë shumë më tepër të pranishëm në të gjitha çështjet që do të jenë pjesë e këtij plani, por edhe në shpjegimet që duhet me i dhënë edhe asamblistëve këtu, sepse nganjëherë ne nuk jemi në situatë t'i kuptojmë të gjitha ato parametra, të gjitha ato situata me të cilat ata merren drejtpërdrejt, sepse jemi për një parim që të pranohet ajo që është e realizueshme.

Këtë propozimvendim plotësisht e përkrahim për miratim.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, propozoi që këto katër plane rregulluese të qiten në votim dhe të shkojnë bashkë, në paketë.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se nëse nuk nxirret mësim prej lagjes "Mati 1", por vetëm bëhet emitim i atij plani, atëherë kjo nuk do të jetë në rregull. Ndërtesa 8 kate, 9 kate, 7 kate, me rrugë 4 metra, besoj se do ta kenë parasysh që mos t'i bëjnë ashtu më.

Sadri Ramabaja, Lëvizja Vetëvendosje, tha se shpresoj që ky plan së paku të na vijë definitiv dhe mos t'i kthehemi edhe njëherë sikur planit "Mati 1", dhe ju bëj thirrje që para se të shkoni te hartimi i planit rregullues të lagjes "Mati 2", t'i riktheheni planit "Matit 1", sepse atje është bërë një katrohurë.

Pika e katërt e pestë dhe e gjashtë

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit, duke cekur se ishte një pajtim i plotë me shëfat e GP-ve, që pika e katërt, e pestë dhe e gjashta e rendit të ditës, pasi që është inicim i plotësimit dhe ndryshimit të planeve rregulluese urbane, për shqyrtim të shkojnë në paketë.

Bexhet Musliu tha se duke pasur parasysh disa vështirësi, të cilat janë paraqitur gjatë realizimit të këtyre planeve, është propozuar që të iniciohen ndryshimi dhe plotësimi i Planit rregullues urban të lagjes "Lakërishta", lagjes "Sofalia" dhe lagjes "Arbëria 3".

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, i përkrahi

pozimvendimet për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të planeve rregulluese urbane të lagjeve: “Lakërishta”, “Sofalia” dhe “Arbëria 3”.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, pyeti se këto ndryshime dhe plotësime të këtyre planeve, a do t'i bëjnë të njëjtat firma të cilat i kishin hartuar këto plane.

Propozoi që të mos jenë 13 rrethrotullime në lagjen “Arbëria”, të zvogëlohet numri i tyre dhe të rritet 20% i mundësisë së shfrytëzimit të parcelës në Sofali.

Një brengë tjetër rreth lagjes “Sofalia”, që aty ku thuhet se destinimi është park publik, ndërsa pronat janë private. Kërkoj që këto projekte të mos ndërtohen në pronat kontestuese.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, përkrahu marrjen e këtij vendimi, pasi që është obligim ligjor dhe i takon Komunës së Prishtinës.

Në mungesë të parametrave urbanë të mirëfilltë që kanë qenë në planin strategjik të zhvillimit nëpër zonat në tërësi, të pasinkronizuara mirë me zhvillimin urban, si rezultat i kësaj po vijmë tash para kësaj sfide edhe ndërhyjmë në planet rregulluese. Për mos realizimin e këtyre planeve rregulluese, kërkoj që të vihet edhe çështja e përgjegjësisë.

I përkrahim për miratim në paketë këto tri propozimvendime.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, tha se jemi për funksionalizimin e tërësishëm, edhe planeve rregulluese në këtë rast, edhe për krijimin e kushteve për zbatimin e tyre. I përkrahim për miratim këto tri propozimvendime.

Besa Rafuna, në emër të GP të LDD-së, tha se jemi për fillimin e ndryshimeve të planeve rregulluese urbane të lagjeve: “Lakërishta”, “Sofalia” dhe “Arbëria 3”.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, përkrahu marrjen e këtyre vendimeve, por e shfaqti një brengë.

Duhet insistuar në përgjegjësinë e atyre që kanë punuar deri tash dhe se fjala ndryshim pak sa na pengon, andaj këto gjëra duhet t'i shohim më herët.

Kërkoj që të mos të vazhdojë përherë kështu me ndryshime, se Kalabrinë e kemi miratuar njëherë kështu, pastaj dolën disa probleme.

Sadri Ramabaja (LV) tha se kur na vijnë për shqyrtim dokumentet e kësaj natyre, është se është kategori ligjore dhe duhet të ecet tutje. Kategori ligjore është edhe ndëshkimi i atyre që nuk e kanë kryer punën si duhet, por ne nuk jemi dëshmitarë se po ndëshkohen asnjë prej tyre.

Mendimi ynë është se praktikisht kjo formë, kjo mënyrë e kryerjes së punëve, është mënyra më e përshtatshme për shpërblimin e firmave klienteliste.

Me shumicë absolute votash, një kundër (Sadri Ramabaja), u miratuan Vendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues urban të lagjes “Lakërishta”, lagjes “Sofalia” dhe lagjes “Arbëria 3”.

Pika e shtatë

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të sallës universale kulturore në Prishtinë, Behxhet Musliu i njoftoi të pranishmit, duke thënë se në bazë të kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka filluar shqyrtimi i lokacionit të mundshëm për ndërtimin e objekteve të parapara nga Drejtoria e Kulturës.

Vjollca Dibra, në emër të GP të LDK-së, tha se qyteti i Prishtinës si një metropol, ka pasur një mangësi të madhe në kuptim të aspektit të infrastrukturës kulturore. Sallat të cilat i kemi shfrytëzuar deri më sot kanë qenë shumë minore për një publik kryeqytetas artdashës, si dhe për komunitetin e artistëve që kryesisht veprimtarinë e tyre e zhvillojnë në Prishtinë. Megjithatë, ndërtimi i sallës universale të kulturës është dukshëm projekt i madh dhe shumë i nevojshëm, prandaj shumë e përgëzoj Drejtorinë e Kulturës që do ta begatojë Prishtinën me një sallë, që gjithsesi i takon ta ketë një sallë ashtu siç e kanë tradicionalisht edhe qytetet e tjera të vendit.

Salla me 700 ulëse është sallë që mund t'i plotësojë mjaftueshëm nevojat e elitës sonë. Ajo që është shumë e rëndësishme është se ky projekt, në aspektin e akustikës, duhet t'i plotësojë kriteret që determinojnë kualitetin e një salle koncertale apo një shtëpie kulture.

Do të dëshiroja që sa më parë të vazhdohet me ndërtimin e këtij objekti tejet të rëndësishëm për kulturën kosovare dhe kryeqytetase.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, e përkrahu këtë projekt dhe i uroi punë të mbarë drejtoreshës dhe realizim sa më të shpejtë të ndërtimit të këtij objekti.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, e përkrahu realizimin e këtij projekti, duke thënë se të gjithë ne jemi të vetëdijshëm se Komunës së Prishtinës i ka munguar kjo. Duke pasur parasysh se ky do të jetë donacion, edhe ne përshëndesim dhe e përkrahim.

Astrit Hasani, në emër të GP të AAK-së, e përshëndeti këtë iniciativën për ndërtimin e objektit të sallës universale kulturore në Prishtinë. E përkrahim këtë projekt shumë të qëlluar dhe të nevojshëm për artin dhe kulturën në komunën e Prishtinës.

Besa Rafuna, në emër të GP të LDD-së, e përgëzoi Drejtorinë e Kulturës për këtë propozim shumë të qëlluar dhe të domosdoshëm për kryeqytetin tonë, prandaj e përkrahim dhe dëshirojmë që ky projekt të realizohet.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, e përkrahu këtë propozim dhe uroi që të realizohet sa më shpejt.

Sadri Ramabaja, Lëvizja Vetëvendosje (LV), e përkrahu dhe e përshëndeti një iniciativë të tillë.

Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e sallës universale kulturore në Prishtinë.

Pika e tetë

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të banimit për rastet në përkujdesje sociale dhe objektit të banimit për familje të dëshmorëve, invalidët dhe veteranët e luftës dhe nevojat e shpronësimeve, informoi Behxhet Musliu, i cili tha se Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale i është drejtuar Drejtorisë së Urbanizimit, Mbrojtjes së Mjedisit për hulumtimin, caktimin e një lokacioni të përshtatshëm për ndërtimin e një objekti me destinim për zgjidhjen e banimit të personave me përkujdesje sociale dhe për familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës dhe për nevojat e shpronësimeve.

Prof. dr. Isa Mustafa, Kryetar i Komunës, tha se ky propozimvendim ka ardhur si propozim i Komisionit për ndarjen e banesave për kategoritë e invalidëve dhe veteranëve të luftës, dhe familjeve të dëshmorëve, sepse është vlerësuar se në këto nuk mund t'i trajtojmë si raste sociale, por duhet të trajtohen ndryshe dhe t'iu ofrojmë mundësi që ata të kenë kushte të banimit. Këtë çështje e trajtuam edhe me shefat e grupeve parlamentare që të zgjerohet kjo, jo vetëm me rastet e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve dhe veteranëve, por edhe për rastet sociale.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, e përkrahu këtë propozimvendim, për arsye se është diçka që i kemi borxh këtyre kategorive të dala nga lufta.

Duke u nisur nga fakti se disa ndoshta e kanë pasur gjendjen e keqe dhe kanë aplikuar, edhe pse tash kur e shikon proporcionin se kush është në listë dhe sa janë të familjeve të dëshmorëve e sa janë të tjerë, prapë po janë të shkelur dhe të injoruar. Mbështetur në këtë, po e ndiej obligim me e thënë një fjali, që e kam thënë edhe në Komitetin për Politik dhe Financa, dhe gjithmonë do të jem ihtarë i asaj dhe do të jem njëri prej atyre që ashpër do t'i godas parregullsitë që po bëhen, prandaj le ta kemi parasysh këtë çështje dhe, në anën tjetër, le të veprojmë ashtu siç duhet.

Shefki Gashi, për këtë propozimvendim e falënderoi kryetarin e Komunës, e falënderoi edhe ekzekutivin që në këtë rast jo vetëm që e kanë bërë një veprim shumë të mirë dhe shumë pozitiv, që i demanton frazeologjitë e njerëzve të tjerë të subjekteve tjera politike, por është një gjest sa human, aq edhe me vend.

Në këtë rast, unë përveç falënderimit, kam edhe një kërkesë, që këtu në vendim të përshkruhet objekti për banim për familjet e dëshmorëve, invalidë dhe veteranë të luftës dhe nevojat e shpronësimeve.

E falënderoj z. kryetar, Asamblenë dhe ekzekutivin për këtë propozim.

Aziz Pacolli shprehu besimin se kjo do ta zbusë pak a shumë këtë gjendje që kemi, ose ndoshta mund të ndodhë nëse janë të gjithë ata që kanë konkurruar për një banesë të tillë, invalidët do të vendosen pavarësisht nëse ka edhe të tjerë, së paku e zbut ose e zvogëlon numrin e tyre që janë me nevoja. E përshëndes dhe

uroj që në mbledhjen e gushtit të jenë të gjitha parametrat që të fillohet tenderimi dhe ndërtimi i atyre objekteve.

Feti Mehdiu e përgëzoi si iniciativë këtë propozim edhe e përkrahu plotësisht.

Mejreme Berisha, ngriti një shqetësim, duke thënë se në të gjitha ndarjet, mund të përvidhen edhe ata që kanë mundësi të bëjnë prapaskenë apo dallavere, mirëpo një gjë shumë po më rëndon këtu në këtë seancë, sidomos për kategoritë e dala nga lufta. Pa marrë parasysh a jemi pjesëmarrës apo nuk jemi pjesëmarrës të luftës, ne jemi pjesë e këtij vendi, pjesë e këtyre njerëzve dhe çka është më e dhimbshme, është ajo që kur shoqatat e dala nga lufta nuk kanë qenë meritore dhe nuk shihen si meritore.

Propozoj që Rregullorja për ndarjen e këtyre banesave të shikohet edhe një herë, sepse nuk është në rregull. Në këtë kategori është dashtë të përfshihen edhe ish - të burgosurit politikë të Kosovës që kanë dhënë shumë për këtë vend.

Ajnishahe Azemi tha se ky propozimvendim është shumë i qëlluar, shumë i rëndësishëm për përkushtimin që e tregon Komuna e Prishtinës për qytetarët e saj. Mendoj se në këtë propozimvendim është dashtë të futet edhe një kategori, *kategoria e personave me aftësi të kufizuara*, të cilët kanë nevojë për strehim.

Sadri Ramabaja tha se me një propozimvendim të veçantë do të ishte fare lehtë e mundshme që obligimin politik dhe qytetar ndaj kësaj kategorie, ta trajtojmë në mënyrë tjetër, të dinjitetshme. Nuk është e pa dinjitetshme edhe trajtimi i rasteve sociale, por në gjithë botën e qytetëruar rastet sociale trajtohen në mënyrë specifike dhe rastet e atyre që kanë dhënë për këtë vend, andaj kërkoj që kjo kategori të trajtohet si kategori e veçantë. Kam thënë edhe më parë, kur është diskutuar për një çështje të tillë, meqë numri i kësaj kategorie nuk është i madh, kjo mund të realizohet për 24 muaj, pra si donacion me vullnetin e dy firmave të Durrësit, ku nga Komuna kërkohet vetëm të gjendet një lokacion i mundshëm.

Astrit Hasani kërkoi që të ketë më shumë transparencë lidhur me këtë çështje, por edhe Komisioni të shikojë për së afërmi gjendjen reale të atyre rasteve sociale.

Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të banimit për rastet me përkujdesje sociale dhe objektit të banimit për familje të dëshmorëve, invalidët dhe veteranët e luftës dhe nevojat e shpronësimeve.

Pika e nëntë dhe e dhjetë

Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme

Kimet Zeqa ngriti shqetësimin rreth mos funksionimit të Komitetit për shëndetësi, duke shtuar se sipas Rregullores për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve, në mbledhjen e tyre të parë të çdo vitit, komitetet duhet të caktojnë datat e mbajtjes së takimeve të rregullta gjatë vitit. Data mund të ndryshojë, por i propozoj kryesuesit të merr masa, ose të diskutojë ku e ka vendin ose me drejtorë. Edhe kryetari është i informuar se që 1 vit nuk është

mbajtur asnjë takim i Komitetit të Shëndetësisë. Këtë çështje e kam potencuar edhe më parë. Nëse nuk ka në shëndetësi probleme dhe nevoja për takime, për diskutime, kam thënë edhe herën e kaluar, atëherë të mos ekzistojë ky komitet, sepse disa gjëra nuk i kisha diskutuar këtu, por i kisha diskutuar në Komitet.

Sa i përket klimave, jam e interesuar shumë të bëhet një hap shumë i shpejtë nga Drejtoria e Shëndetësisë, të shihet se ato klimat që kanë ardhur, 30 sosh, ku janë vendosur. Kërkoj që ato të vendosen ku është më se e nevojshme, e jo sipas të njohurve, pra të vendosen aty ku ka nevojë më shumë, qoftë te internisti, te reumatologu etj.

Lidhur me mos funksionimin e Komitetit për shëndetësi, kryesuesi dha sqarime të nevojshme.

Naim Makolli fillimisht u ndërlidh rreth çështjes së trafikut urban, konkretisht rreth linjës nr. 3, duke shtuar se kjo linjë edhe sot e kësaj dite, 10 viteve pas luftës, nuk funksionon si duhet.

Dua ta shtroj një shembull që ta shohim pak më ndryshe këtë çështje.

Policët e stacionit në lagjen "Kodra e Trimave" për të shkuar në punë, shumica presin te Xhamia e Llapit ose nëpër stacione tjera. Është shumë interesant, ata hipin në kombi, dalin lart e paguajnë kombin, e veshin uniformën dhe dalin pas nja gjysmë ore në rrugë dhe i dënojnë kombibusët. Shtrohet pyetja kështu ata kombi që po punojnë atje, a duhet t'i falënderojmë në një farë forme që po punojnë ilegalisht dhe po e mbajnë gjallë atë linjë, sepse vërtet e mbulojnë 70% të atij trafiku të asaj linje, apo duhet t'i dënojmë ashtu në atë formë. Kanë funksionuar si kanë funksionuar deri tash, por shtrohet një brengë, sepse kohëve të fundit ata udhëtarë që i gjejnë nëpër kombibusë që udhëtojnë në këto linja, unë po flas për linjën 3, por edhe për të tjerat, ndoshta ka probleme të tilla, policia kur i ndalon ua merr edhe letërnjoftimet dhe tash ka filluar një gjobë edhe ndaj udhëtarëve. Si t'ia bëjmë këtij problemi ne, a është në rregull kjo, sepse nuk ka mundësi ndryshe të udhëtohet në linjën nr. 3. Për momentin po flasim nëse nuk ka kombibusa, ne e dimë që është ilegal, por kësaj pune duhet t'i bëhet një zgjidhje.

Çështje tjetër që vlen të diskutohet është edhe rruga Viti - Bullaj. Kërkoj nga drejtori të na tregojë se kur do të filloj asfaltimi i saj. Kjo rrugë është e shtruar me zhavorr dhe nuk është bërë ngjeshja e saj ashtu si duhet. Problem tjetër është që aty janë dy pika shumë të ndjeshme, që nuk janë paraparë nga kompania, e që nuk janë marrë parasysh sugjerimet e fshatarëve për një përrua. Në momentin kur ka vërshime ai do të përfshin 50 metra rrugë, andaj nuk është parë e rrugës që aty të futen gjashtë gypa që ta bëjnë kalimin e përroit!

Në rrugët e lagjes “Kodra e Trimave” shumë pakë është bërë dezisenktimi i tyre. Edhe sot fatkeqësisht një pjesë, sidomos të atyre lagjeve që jetojnë përgjatë përroit që lidhet prej fundit të lagjes “Kodra e Trimave” dhe bie në Shkabaj, atje është e padurueshme prania e madhe e mushkonjave. Lidhur me këtë çështje kisha me shtruar edhe pyetjen rreth atij përroi, a ka diçka në projekt që të mbulohet ai përrua, të paktën në ato pjesë ku është e banueshme se është nja 500-600 metra që shtëpitë janë vënë deri në përrua, ku kemi kundërmim, sepse krejt kanalizimet dhe ujërat e zeza të një pjese të madhe të lagjes “Kodra e Trimave” bien në atë rrugë.

Kam edhe një kërkesë për rregullimin e rrugës nga Prapashticës deri te Varrezat e dëshmorëve, gjithashtu kërkesa e fshatarëve të lagjes Canaj për rregullimin e rrugës deri te Bullajt, pasi që tash për tash ajo rrugë është e pakalueshme.

Edhe kërkesa tjetër që është për ndërtimin e një rruge prej lagjes Bullaj deri në fshatin Krilevë, që lidhet me komunën e Dardanës, duhet të shpërthej ajo grykë, sepse gjithmonë ka qenë e kalueshme ajo rrugë dhe sot në shek. 21, të kemi përgjigje prej zyrtarëve që ajo nuk mund të jetë e kalueshme, është kanjon, është e pa pranueshme për qytetarët. E dimë se do të ketë probleme për disa prona private, mirëpo ne qytetarët kemi shprehur njëfarë vullneti që ndoshta ato prona private vetë t’i kompensojmë disi, por vetëm ajo rrugë të fillojë dhe të vazhdojë deri në fund.

Shefqet Sylejmani ngriti shqetësim për mosqëndrim të drejtorëve, por edhe të këshilltarëve, deri në fund të mbledhjes, duke thënë se këto pika ose le të jenë obliguese, ose kështu nuk kemi nevojë t’i mbajmë fare.

Kamë një kërkesë ose propozim, meqë jemi në kohën kur vijnë bashkatdhetarët dhe bashkëkombësit tanë nga jashtë, ku shumica prej tyre kanë nevoja për disa shërbime që i ofron Komuna, siç është certifikata etj.

Kërkesa ime është edhe lutja ime që të forcohet Shërbimi i ofiqarisë me punëtorë, qoftë edhe ndonjë shërbim tjetër, të zgjatet ndoshta edhe koha e orarit të punës, në mënyrë që ata të mund të kryejnë punët e veta në një afat sa më të shkurtër, se shumica prej tyre rrinë 10-15 ditë. Dhe, në anën tjetër, është një kategori, më duket në nivel qendror, atyre që dëshirojnë të kryejnë disa shërbime për kohë më të shkurtër, iu kërkohet të paguajnë pak më shtrenjtë, 100 € etj. Unë mendoj që Komuna, por as niveli qendror, nuk guxojnë ta bëjë një gjë të tillë, mendoj se është diskriminim vërtet i papranueshëm për bashkatdhetarët tanë.

Çështja tjetër është ajo e infrastrukturës, që ish-rruga “Shkupi”, gjegjësisht pjesa që e tangon Vetanikun, tash rr. “Behar Begolli”, e cila është vizavi me rrugën e Veternikut, pra është kërkesë e qytetarëve atje, është një segment i cili shumë do ta lehtësonte problemin e Veternikut, d.m.th. kësaj rrugës Prishtinë – Shkup – Prizeren, sidomos në rastet kur po ndodhin ndonjë problem në rrugë etj. do ta zgjidhte mundësinë e një alternative, dhe njëherësh e lehtëson shumë qarkullimin e njerëzve që udhëtojnë në drejtim

të Gjilanit, është një segment shumë i vogël. Unë nuk e di pse nuk po kryhet ajo pjesë e rrugëve!

Kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale që të intensifikohen punët për përfundimin e saj.

Çështje tjetër që vlen të theksohet është edhe problemi i dezinfektimit në pjesën e banesave të Komunës, gjegjësisht të kompleksit banesor “Dielli”. Kohëve të fundit janë shfaqur disa buba që shumëzohen shumë shpejt, një herësh është kërkesë edhe e qytetarëve, banorëve, andaj kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që të merren masa për eliminimin e tyre.

Mejreme Berisha tha se përhapja e këtyre bubave është shumë shqetësuese për banorët e qytetit. Problem tjetër që duhet theksuar është se autobusi i linjës “Profiti” nuk e respekton aspak relacionin e paraparë sipas rregullores, andaj është momenti i fundit që të ndërmerret diçka për rregullimin e kësaj çështje.

Çështje tjetër është se në fshatin Koliq, me të përfunduar mësimi, nuk ka qarkullim për këtë fshat. E njëjta gjë është edhe për fshatin Sharban. Kërkoj nga drejtoria që edhe për stinën e verës të ketë qarkullim për Koliq.

Një pyetje tjetër, çka më ka tërhequr pyetja e koleges, Lumnije Rama.

Sheshi Zahir Pajaziti, shumë mirë që quhet sheshi Zahir Pajaziti, por vërtet nuk është kulturë kombëtare, nacionale, krenare, të them nëse them vetëm sheshi Zahir Pajazitit. Ata ranë të tre për një ditë, çka na kushton neve si komunë ta quajmë sheshi i tre dëshmorëve apo tre heronjve.

Si të dojë le ta zgjedhë Komuna, por mos ta quaj vetëm sheshi Zahir Pajaziti, për arsye se Zahir Pajaziti ka qenë i Gollakut, tjetri i Llapit, tjetri i Dukagjinit, prandaj është mëkat të thuhet vetëm sheshi Zahir Pajaziti, ata kanë respekt në gjithë zemrat e popullit.

Kam edhe një pyetje tjetër. A po i bën Komuna këto fasada me përforcime që tash janë nëpër ndërtesat e komunës sonë, apo po i bënë ndonjë organizatë private?

Kërkoj që ndaj pronarëve të lokaleve të merren masa, që me karriget e tyre të mos i zënë trotualet, pasi që pengojnë lëvizjen e lire të këmbësorëve.

Ajnishahe Azemi tha se do doja të dija se kur mendohet të fillohet ndërtimi i objektit Qendra për qëndrim ditor të personave me aftësi të kufizuara, e cila është aprovuar me buxhetin e Komunës për këtë vit.

Pyetja tjetër kishte me qenë për drejtorin e Infrastrukturës Lokale. Pyetjet e shtruar edhe më parë se a ka mundësi të dalë një komision dhe të shoh te rruga “Hys Popova” dhe në pjesën e poshtme të shikojë mundësitë e lidhjes së asaj rruge me rrugën “Selman Kadria”, për arsye se ata qytetarë gjatë kohërave kur ka shi edhe kur është moti i lig, kanë shumë vështirësi të kalojnë në atë pjesë. Ajo pjesë është jo shumë e gjatë dhe besoj që me shumë pak mjete do të mund të rregullohej ajo çështje.

Shemsi Veseli tha se edhe në KPF kemi pasur gjuhë të përbashkët që, në të ardhmen, ta mendojmë një pikë të rendit të ditës për kompensimin e pronave pronarëve që iu kanë marrë për interesin e përgjithshëm, andaj ta marrim një vendim dhe të mos i zvarrisim, të mos i ngufasim, të mos jemi në pikërisht pengesë në mosrealizimin e projekteve.

Çështja e dytë që desha të kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit, për hir të interesit të përgjithshëm d.m.th. edhe të opinionit, por edhe tonin pse jo, si prind, është mirë që për mbledhjen e ardhshme të jetë një informatë rreth suksesit dhe njëherësh performancës së testit që kanë hyrë tash, pra do të kishte me qenë mirë një informatë që ta dimë për shkollat e mesme, gjegjësisht edhe për këto filloret, tash klasat e nënta që parapërgatiten, se sinqerisht po vërehet se është një shqetësim nëse e shikojmë përqindjen sa tash kanë qene dhe sa kanë kaluar.

Çështja e tretë, që më nxitën kolegët me thënë, është çështja rreth përhapjes së bubave në objektet e banimit dhe ato quhen "*buba fortare*". Është tejet shqetësuese që me rastin e eliminimit të tyre dhe është fatkeqësia më e madhe që njerëzit për përfitime personale, me hy në gjepat e tyre, realisht kur po intervenojnë, po intervenojnë pikërisht me ato mjete, që shkon prej komshiut te komshiu tjetër edhe nuk largohen prej ndërtesës. Është shumë e vërtet se njerëzit për interesa materiale, janë në gjendje me bërë një dëm jashtëzakonisht të madh publik.

Ridvan Shahini, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, tha se rruga Viti- Bullaj është ndërtuar me material vendor dhe është bërë zgjerimi i trasesë sipas projektit. Asfaltimi nuk mund të bëhet në këtë pjesë, në këtë shtresë, nuk është edhe në program, po na nevojiten edhe 20 cm zhavorr që më pas të asfaltohet.

Në lagjen "Kodra e Trimave" kanë ekzistuar disa kanalizime që kanë qenë edhe më herët të ndërtuara nga ana e kompanisë "Batllava" dhe Komunës, tash me ndërtimin e ri të kanalizimeve, do të inkorporohen krejt këto kanalizime në një kolektor kryesorë.

Rruga Canaj - Brahaj me gjatësi 4 km dhe Lumi i Marevcit - Golimivadë, materiali është dërguar në Zyrën e prokurimit.

Për rrugën prej lagjes së Vrajollëve - Krilevë, i takon territorit të Krilevës dhe për këtë duhet konsultuar edhe me nivelin qendror.

Për ish-rrugën "Shkupi", ajo është e ofertuar, e vlerësuar, pritet nënshkrimi i kontratës dhe besoj se në javën e ardhshme ajo fillon.

Sa i përket këtu mbi tjegullore, janë dy rrugica të vogla "Hys Popova" dhe "Selman Kadria", ato janë të ndërtuara, por lidhja në mes tyre nuk ka ma tepër se deri në 80m, por kalon nëpër dy parcela dhe mendohet se është prone private.

Agim Gashi tha se për linjat në pjesën rurale, ne e dimë të gjithë që ato kanë qenë dhe janë kompetencë e Trafikut Urban. Shumicën e tyre, për shkak të

numrit të vogël të udhëtarëve, nuk ka kompani që mund ta përballojë koston.

Komuna deri më tash nuk ka mundur të sigurojë mjete për subvencionim, ne kemi shfrytëzuar kombinime në mes të kontraktuesve përmes Drejtorisë së Arsimit, për nevoja të shkollës dhe në bashkëpunim me bashkësitë lokale dhe Trafikun Urban për shfrytëzim të atyre operatorëve të cilët i shfrytëzojnë kontratat e arsimit dhe njëkohësisht i kanë bartur edhe udhëtarët për Koliq. Gjatë verës do të ketë problem për ta përballuar koston e shpenzimeve për atë relacion.

Valbon Krasniqi tha se në QKMF po punohet vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të volitshme si për stafin mjekësor, ashtu edhe për pacientë. Sa i përket dezinfektimit, ai është bërë në një sipërfaqe prej 3500 ha. Me këtë projekt tentohet që të bëhet eliminimi i insekteve fluturuese. Për bubat e shfaqura në objektet e banimit duhet marrë veprime të nevojshme për eliminimin e tyre. Deratizimi është bërë në garazhe dhe bodrume të objekteve dhe në rrjetin e kanalizimit. Dezinfektimi është bërë në disa lagje të ndryshme të qytetit.

Sa i përket ndërtimit të objektit për nevoja të veçanta, për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, nuk mund të realizohet ky projekt.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësit, kryesisht që kishin të bënin rreth përfundimit të vitit shkollor dhe për testin e nxënësve, **Halim Halimi**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dha sqarime të nevojshme.

Muhamet Nura, pyetje për drejtorinë përkatëse:

1. Pse edhe pas kaq vitesh nuk largohen kioskat te Shkolla e Mesme Ekonomike (përballë) NPL "Pastrimi"? (pyetje e shtruar edhe më parë në seancat e kaluara dhe nuk kemi marrë përgjigje).
2. Si është e mundur të ndërtohen anekse (prapa) gati çdo ndërtesë në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë dhe të mos trajtohet asnjëra nga to?
Ku është inspekcioni? (kjo vetëm këtë fundjavë ndërtohen anekse te stadiumi në lagjen "Ulpiana"). Qytetarët janë të interesuar që edhe të tjerët të ndërtojnë.
3. Cili është projekti për garazhet prapa Fakultetit Ekonomik - Juridik e gjerë te NK "Sport-Marketing"?
4. A posedojnë leje pune dy pompat e karburantit në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë?
5. Sa antena të operatorëve të ndryshëm janë në territorin e Komunës së Prishtinës dhe a janë të përfshirë në taksa? Sa është shuma e taksave të tyre që jepen në mënyrë të specifikuar për operatorët, edhe pse dihet se janë bukur shumë?

Mbledhja mbaroi në orën 14:15.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Sami Hamiti, ecc. i dipl.